

Specialist/Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike:

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 25/24 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783 datë 18.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.07.2024 “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, urdhrit të Kryeministrit nr. 239, datë 16.12.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist/Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike:**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Evidenton dhe paraqet nevojat e institucionit për shërbime, mjete pune, bazë materiale, sipas kërkesave të stafit, për sigurimin e infrastrukturës mbështetëse;
- Ndihmon strukturën përgjegjëse për prokurimet gjatë hartimit të regjistrit të parashikimit të prokurimeve, lidhur me nevojat e institucionit;
- Ndjek realizimin e shërbimeve dhe furnizimin e mallrave, sipas kontratave të lidhura, për të garantuar infrastrukturën mbështetëse sipas kërkesave të stafit;
- Trajton çështje që kanë të bëjnë me shërbimet mbështetëse të institucionit;
- Ndjek miratimin e udhëtimeve brenda dhe jashtë vendit të stafit dhe evidenton nevojën për karburant gjatë shërbimeve të punës së automjetit të institucionit;
- Përgatit materiale apo shkresa për nevoja të institucionit sipas porosive të eprorit;
- Bashkëpunon me sektorë të tjerë për të siguruar mbështetje logjistike për evente, mbledhje, trajnime dhe aktivitete të tjera institucionale.
- Kryen detyra të tjera të dhëna në varësi të dinamikës së punës, brenda përgjegjësisë së Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Bachelor” në Shkenca Ekonomike, Juridike, Sociale dhe Shoqërore.

Përvoja: Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

FUSHA E NJOHURIVE DHE AFTËSITË:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

-Aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;

-Njohuri të mjaftueshme për përgatitjen dhe hartimin e raporteve administrative bazike dhe analitike në mbështetje të funksioneve të strukturës ku bën pjesë;

- Njohuri dhe përdorim praktik i programeve kompjuterike bazë

- Aftësi të mira organizative për menaxhimin e dokumentacionit, koordinimin e detyrave të përditshme dhe ndjekjen e afateve;

- Aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunuese në punë ekipore dhe në ndërveprim me struktura të tjera të institucionit;

-Njohuri mbi ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (IV-3)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 26.05.2025, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@aksk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
 - Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja;
 - Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - Të paktën një letër rekomandimi.
- . Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.